REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL**
**DREJTORIA E SHERBIMIT SOCIAL**
**SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL**

**Nr. Prot.** **Bilisht më, . .2026**

**PROJEKT-VENDIM**

**NR. 6, DATË 22 / 01 /2026**

**"PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS MESATARE TË TREGUT PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË" QË PËRFITOJNË FAMILJET E PASTREHA QË BANOJNË MË QIRA NË TREGUN E LIRË DHE NUK KANË TË ARDHURA TË MJAFTUESHME PËR TË PËRBALLUAR VETË GJITHË VLERËN E QIRASË PER VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1 shkronja "b", neni 24 dhe neni 54 shkronja "k" dhe nenit 55 pika 2 e 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë" neni 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar, VKM Nr.362 datë 29.05.2019, "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM Nr. 384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr. 301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët" si dhe VKM Nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

**PROPOZOJ:**

1. Të miratojë vleren mesatare të tregut të lirë për subvencionimin e qirasë, sipas VKM nr. 301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", për të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Devoll, si më poshtë;

| Sipërfaqet për çdo lloj banese | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Tipi i njësisë së banimit | Sipërfaqe Neto (m2) | | |
| | | Minimale | Maksimale | Vlera e qirasë |
| 1 | Studio | 30 | 45 | 4000 |
| 2 | 1+1 | 40 | 55 | 5000 |
| 3 | 2+1 | 50 | 81 | 7000 |
| 4 | 3+1 | 60 | 100 | 9000 |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Sektori i Kujdesit Social dhe PAK dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore".

**KRYETARI I BASHKISË**
**EDUARD DURO**

**Konceptoi:** Specialiste për administrimin e nevojave për strehim
Linda Laçi

**Pranoi:** Përgjegjës i sektorit të Kujdesit Social
Marilda Bejleri

**Miratoi:** Drejtor i Shërbimeve Sociale, Shëndetësore dhe Strehimit
Zerina Sinani

**Konfirmoi bazen ligjore:**
Përgjegjëse e Sektorit Juridik
Eriksela Avdo

**Konfirmoi:** Sekretar i Përgjithshëm
Adriana Rushitaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL**
**DREJTORIA E SHERBIMIT SOCIAL**
**SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL**

**Nr.** 288 **Prot.** **Bilisht më,** 22.01.**2026**

# RELACION

## PËR MIRATIMIN E VLERES MESATARE TE TREGUT PER BANESAT SOCIALE ME QIRA

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1 shkronja "b", neni 24 dhe neni 54 shkronja "k" dhe nenit 55 pika 2 e 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë" neni 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar, VKM Nr.362 datë 29.05.2019, "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM Nr. 384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr. 301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët" si dhe VKM Nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Strehimi social është një çështje shumë e ndjeshme dhe prek kategoritë më në nevojë dhe vështirësi për të siguruar një strehim të përshtatshëm, të përballueshëm dhe me të drejta të garantuara pa asnjë lloj diskriminimi pavarësisht nga gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, orientimi seksual, aftësia e kufizuar apo çdo lloj gjendje tjetër që sjell pasoja diskriminuese. Bashkia Devoll nëpërmjet programeve të strehimit social të cilat janë aktive dhe sigurojnë mundësi për të përfituar nga strehimi social, luan një rol të rëndësishëm në ndihmë të familjeve në nevojë për strehim. Për instrumentin financiar " Subvencionimi i Qirasë në Tregun e Lirë" që do të zbatohet nga Bashkia Devoll edhe për vitin 2026, merr një rëndësi të veçantë përcaktimi i vlerës maksimale të qirasë mesatare në treg të lirë brenda territorit që përfshin kjo bashki, në kuptim të pikës 4/a të VKM nr.362 datë 25.09.2019 ku thuhet: "Njësia e vetëqeverisjes vendore përcakton vlerën konkrete të subvencionimit të qirasë për banesat në pronësi të pronarit social në tregun e lirë, bazuar në vlerën mesatare të qirasë në tregun e lirë, e cila vlerësohet sipas zonave të ndryshme urbane e rurale të një njësie të vetëqeverisjes vendore". Vlera maksimale e subvencionimit të qirasë përcaktohet çdo vit, bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetqeverisjes vendore. Referuar masës së qirasë, të fiksuar në kontratat e qirave të përfituesve për 12 muajt e fundit, të cilat mbeten efektive edhe për vitin 2026, për shkak se janë kontrata mbi një vit, gjithashtu